



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSHME

**RAPORTI VJETOR I 2023 PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK  
TË REALIZUAR NGA MINISTRIA E BRENDSHME**

**I. Përmbledhja ekzekutive** (pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera memësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)

Gjatë vitit 2023, Ministria e Brendshme ka kryer procesin e konsultimit duke përmbushur 100% detyrimin që buron nga ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, duke konsultuar në platformë 6 akte të cilat janë miratuar dhe kanë qenë objekt i konsultimit publik për vitin 2023.

Kjo dëshmohet dhe nga pikëzimi i cilësisë sipas metodologjisë SIGMA, e cila shërben për vlerësimin e performancës institucionale në procesin e konsultimit publik, ku cilësia e konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme rezulton maksimale. Kjo sepse për të gjitha aktet e konsultuara të publikuara në sistemin e informacionit qeveritar (RENJK), është hartuar raporti individual i secilit akt, mbi përfshirjen e palëve të interesit dhe janë mbledhur prova të mjaftueshme mbi reagimet e tyre, një pjesë e mirë e të cilëve janë bërë pjesë e aktit final e të miratuar.


Nga monitorimi i platformës së Regjistratit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK), vihet re se ka pasur një numër total prej 3955 vizitorësh për të gjitha aktet e konsultuara në këtë platformë, ndërkohë që konsultimi publik është realizuar edhe nëpërmjet tryezave të konsultimit publik, ku ka pasur një përmirësim të përfshirjes së aktorëve me përfshirjen e disa grupeve interesi, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre.

Përzgjedhja e akteve është bërë në përputhje me ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Në zbatim të nenit 1, të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” përcaktohet shprehimisht se ky ligj rregullon procesin e konsultimit publik për projektligjet dhe projekt dokumentet strategjike kombëtare dhe vendore.

Në zbatim të urdhrit nr. 3, datë 21.1.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e udhëzuesit për procesin e konsultimit publik”, konsultimi publik është parashikuar të realizohet edhe për ato projektvendime të cilat vlerësohen të një interesi të lartë për publikun, pra jo vetëm për projektaktet që kanë detyrimin për t’iu nënshtruar këtij procesi në përputhje me parashikimet e nenit 1, të ligjit të sipërcituar.

Ndërsa në nenin 4, të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, është parashikuar lista e projektakteve që nuk i nënshtrohet procesit të konsultimit publik, siç janë çështjet e sigurisë

kombëtare që përbëjnë sekret shtetëror, marrëveshjet ndërkombëtare, aktet normative të KM me fuqinë e ligjit, emergjenca civile dhe çështje të tjera të parashikuara me ligj. Rrjedhimisht aktet e Ministrisë së Brendshme, të cilat janë të kësaj natyre, janë përjashtuar nga ky proces duke i evidentuar në planin e veprimit, sipas përjashtimit përkatës ligjor.



## **2. Analiza e konsultimeve të krvera**

### ***2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike***

Numri i akteve të Ministrisë së Brendshme që i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik gjatë vitit 2023 është 6 (gjashtë) akte:

1. Për disa ndryshime në vendimin nr.1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025 dhe planin e veprimit 2021–2022;
2. Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.75/2014, “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”;
3. Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023–2025 dhe të planeve të veprimit 2023–2025;
4. Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.74/2014, “Për armët”, të ndryshuar;
5. Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.113/2020, “Për shtetësinë”;
6. Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030, të planit të saj të veprimit 2023-2025 e të pasaportës së indikatorëve.

#### ***2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?***

Numri i përgjithshëm i akteve të miratuara për vitin 2023 nga Ministria e Brendshme është 14 akte. Nga të cilat 6 akte janë objekt i ligjit për konsultim publik dhe janë konsultuar sipas përcaktimeve ligjore për procesin e konsultimit publik.

### 2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Janë konsultuar 100% e akteve të miratuara dhe që i nënshtrohen konsultimit publik.

### 2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Të tre ligjet e miratuar dhe konsultuara në RENJK, janë konsultuar me VNR për vitin 2023.

### 2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përgjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Nga 31 projektakte, të cilat janë në përputhje me PKIE, PPAP dhe Dokumentet Strategjike, për 25 projektakte janë përdorur kriteret/përgjashtimet nga konsultimet publike, ku pjesa më e madhe e tyre është përgjashtuar për kriterin e natyrës individuale të aktit administrativ.

Më konkretisht:

- **1 akt** është përgjashtuar pasi në përmbajtje të tij është shtuar vetëm emri i një institucioni;
- **24 akte** janë përgjashtuar për kriterin “*aktet administrative individuale dhe aktet administrative normative*”.



### 2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Aktet e konsultuara janë të natyrës projektligje dhe projektvendime, ku përfshihen edhe plane veprimi të strategjive të ndryshme. Koncretisht i janë nënshtuar konsultimit publik 6 akte, nga të cilat 3 (tre) projektligje dhe 3 (tre) projektvendime së bashku me planet e veprimit.

### **2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?**

Krahasuar me një vit më parë, konkretisht konsultimi në vitin 2022, në 2023 vihet re një numër më i madh akteve të parashikuara të konsultuara, të cilat janë konsultuar si nëpërmjet regjistrit elektronik për njoftimin dhe konsultimin (RENJK), ashtu edhe nëpërmjet takimeve konsultative me gupet e interesit. Një pjesë e mirë e tyre janë konsultuar nëpërmjet platformave të ndryshme online, për një përfshirje më të gjerë të palëve të interesuara. Megjithatë, krahasuar me vitin e kaluar, në vitin 2023 kemi një organizim më të madh të takimeve konsultative fizikisht, të zhvilluara në të dyja fazat: si në fazën paraprake ashtu edhe në fazën e konsultimit publik.

## **2.2. Metodat e konsultimit**

### **2.2.1. Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)**

Metodat e përdorura për konsultimin publik gjatë kësaj periudhe ishin 3 (tre):

1. Konsultim gjatë hartimit të draftit të aktit nëpërmjet grupit të punës dhe ekspertizës së ekspertëve të ndryshëm sipas fushave përkatëse, apo përfaqësues të organizatave ndërkombëtare të cilat asistojnë institucionin tonë;
2. Tryeza të konsultimit publik pas përgatitjes së aktit, me aktorët e targetuar si: shoqëri civile, shoqata, organizata kombëtare po ndërkombëtare (të zhvilluara fizikisht apo online për shkak të pandemisë);
3. Konsultimi në faqen zyrtare të regjistrit elektronik për konsultimin dhe njoftimin (RENJK).

Të gjitha projektaktet që i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme për vitin 2023, janë konsultuar nëpërmjet Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK), si dhe konsultimit nëpërmjet tryezave të konsultimit.

### **2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?**

Metoda që gjeneroi numrin më të madh të komenteve ishte ajo e tryezave të konsultimit.

Numri i komenteve përmes konsultimit në fazën paraprake të draftimit të aktit, ka qenë i lartë referuar ekspertizës së ekspertëve të ndryshëm, njohës të mirë të fushave përkatëse sipas akteve, si dhe ekspertëve përfaqësues të organizatave ndërkombëtare. Këtu mund të përmendim asistencën me ekspertë të Zyrës së Evropës Juglindore dhe Lindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta SEESAC, të cilët kontribuan në hartimin e akteve në zbatim të ligjit “Për armët”, ekspertë përfaqësues të UNICEF për hartimin e Planit të Veprimit për luftën kundër trafikimit të personave, apo kontributi i tryezave publike të Këshillit Konsultativ të Qeverisë Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore, me pjesëmarrjen e: NJVV, donatorë të huaj, drejtues të projekteve të ndryshme në lidhje me vetëqeverisjen vendore, përfaqësues nga ambasada të ndryshme, Këshillat e Qarqeve, etj.

Konsultimit nëpërmjet zhvillimit të tryezave me aktorët e targetuar dhe shoqëritë civile, ka qenë shumë produktiv, duke gjeneruar numrin më të madh të komenteve të përfituara gjatë këtij procesi.

Për sa i përket konsultimit publik nëpërmjet regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (RENJK), bëjmë me dije se nuk ka pasur asnjë koment edhe pse numri i vizitorëve në këtë portal për aktet e konsultuara ishte 3955.

### ***2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nësepo, në sa raste?***

Ministria e Brendshme ka zhvilluar konsultime paraprake me teknikët apo ekspertët njohës të mirë të fushës së aktit, gjatë fazës së hartimit të të gjithë akteve:

1. Për disa ndryshime në vendimin nr.1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025 dhe planin e veprimit 2021–2022;
2. Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.75/2014, “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”;
3. Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023–2025 dhe të planeve të veprimit 2023–2025;
4. Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.74/2014, “Për armët”, të ndryshuar;
5. Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.113/2020, “Për shtetësinë”;
6. Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030, të planit të saj të veprimit 2023-2025 e të pasaportës së indikatorëve.

Këto akte për shkak të natyrës teknike apo komplekse, i janë nënshtruar konsultimit paraprak gjatë draftimit në grupe pune.

### ***2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve***

#### ***2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?***

Për të gjitha aktet që i janë nënshtruar procesi të konsultimit publik, është kryer publikimi në RENJK, duke respektuar afatin ligjor prej minimumi 20 ditë pune. Për as i përket konsultimeve nëpërmjet metodave të tjera, ato janë zhvilluar për një periudhë më të gjatë, duke përfshirë një muaj të plotë pune, për shkak të kompleksitetit dhe rëndësisë të secilit akt.

- Për disa ndryshime në vendimin nr.1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 dhe planin e veprimit 2021-2022, ka qëndruar në platformën e konsultimit prej datës 9 dhjetor 2022

deri në 25 janar 2023.

- Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030, të planit të saj të veprimit 2023-2025 e të pasaportës së indikatorëve, po ashtu ka qëndruar në platformën e konsultimit prej datës 9 dhjetor 2022 deri në 25 janar 2023.

### ***2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?***

Konsultimi publik në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) për të gjitha aktet e planifikuara gjatë vitit 2023, u realizua në përputhje me ligjin nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, përkatësisht me nenin 15 të tij. Konsultimet patën një kohëzgjatje mesatare prej 20 ditësh pune duke filluar nga data e publikimit.

Kurse kohëzgjatja mesatare e projektakteve të konsultuara nëpërmjet të gjitha metodave të konsultimit, duke përfshirë dhe konsultimin paraprak, i cili varion disa muaj për secilin ka qenë 6,5 muaj. Kjo mesatare është rezultat i mbledhjes së të gjitha afateve të kohëzgjatjes së procesit të konsultimit, të të gjitha akteve, duke përfshirë dhe fazën paraprake, pjesëtuar për numrin e akteve të konsultuara.

### ***2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?***

Krahasuar me një vit më parë, kemi një gjenerim më të madh të komenteve të ardhura nëpërmjet zhvillimit të takimeve dhe konsultimeve nëpër tryeza publike. Kurse të dhënat e përfituara nga Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike tregojnë se numri i vizitorëve ka qenë më i lartë se numri i një viti më parë (për vitin 2021, 2384 vizitorë, kurse për vitin 2022, 2384).

Situata këtë vit është përmirësuar në kuadër të marrjes së kontributit dhe komenteve nga grupet e interesit, kjo sepse ka pasur një angazhim të rolit të koordinatorit të procesit të konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme, me bashkëpunimin më efektiv dhe me strukturat teknike hartuese të akteve, të cilat kanë pasur më të lehtë identifikimin e grupeve të interesit të përfshira në dhënien e kontributit të tyre, në vijim të trajnimeve të zhvilluara.

## ***2.4. Palët e interesuara të përfshira***

### ***2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?***

Për vitin 2023 ka pasur një numër të madh të pjesëmarrjes së ekspertëve të fushës apo përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe organizatave ndërkombëtare, konkretisht:

- Misionet/partnerët ndërkombëtare që ofrojnë bashkëpunim në fushën e sigurisë për Ministrinë e Brendshme si SEESAC.
- Organizata të tjera ndërkombëtare apo private si UNICEF.
- Aktorë qeveritarë si anëtarë të Komiteteve Rajonale (KRAT) të qarqeve: Tiranë, Dibër, Shkodër, Kukës, Korçë dhe Vlorë, prefektët e qarqeve dhe administratat e tyre, kryetarët

- e Bashkive dhe kryetarë të Këshillave Bashkiak.
- Këshilli Konsultativ i Qeverisë Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore, me pjesëmarrjen e: Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, donatorë të huaj, drejtues të projekteve të ndryshme në lidhje me vetëqeverisjen vendore, përfaqësues nga ambasada të ndryshme, Këshillat e Qarqeve.
  - Shoqëri të ndryshme civile.

**2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)**

Për konsultimin e projektakteve gjatë vitit 2023, ka pasur pjesëmarrje nga ekspertë të ndryshëm, të cilët janë kontraktuar nga MB ose kanë dhënë asistencën e tyre nëpërmjet takimeve të ndryshme konsultuese si:

- ekspertë individual;
- përfaqësues nga organizatat ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë;
- përfaqësues nga institucione publike të pavarura apo institucione të varësisë;
- përfaqësues nga ambasada të ndryshme.

**2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?**

**Rreth 100 ekspertë** të fushave të ndryshme, kryesisht të sigurisë, apo përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe organizatave ndërkombëtare, të përmendura sa më sipër.

**2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?**

- Misionet/partnerët ndërkombëtare që ofrojnë bashkëpunim në fushën e sigurisë për Ministrinë e Brendshme si SEESAC.
- Organizata të tjera ndërkombëtare apo private si UNICEF.
- Aktorë qeveritarë si anëtarë të Komiteteve Rajonale (KRAT) të qarqeve: Tiranë, Dibër, Shkodër, Kukës, Korçë dhe Vlorë, prefektët e qarqeve dhe administratat e tyre, kryetarët e Bashkive dhe kryetarë të Këshillave Bashkiak.
- Këshilli Konsultativ i Qeverisë Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore, me pjesëmarrjen e: Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, donatorë të huaj, drejtues të projekteve të ndryshme në lidhje me vetëqeverisjen vendore, përfaqësues nga ambasada të ndryshme, Këshillat e Qarqeve.
- Shoqëri të ndryshme civile.

**2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?**

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara ka ardhur duke u përmirësuar. Kjo gjë konstatohet nga rritja e numrit të pjesëmarrësve në tryezat e konsultimit të organizuara nga Ministria e Brendshme.

Gjithashtu, është përmirësuar edhe sepse ka pasur një angazhim më të madh të rolit të koordinatorit të procesit të konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme, kjo dhe si rezultat i trajnimeve të zhvilluara, të cilat kanë ndikuar në të kuptuarit më mirë të rëndësisë dhe në menaxhimin më të mirë të këtij procesi, si dhe në bashkëpunimin me efektiv me strukturat teknike hartuese të akteve, të cilat kanë pasur më të lehtë identifikimin e grupeve të interesit të përfshira në dhënien e kontributit të tyre.

## **2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra**

### **2.5.1. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?**

Nga konsultimi përmes Regjistrisë Elektronike për Njoftimet dhe Konsultimet, nuk ka pasur asnjë koment të marrë për aktet e konsultuara përgjatë vitit 2023. Pjesa më e madhe e komenteve janë përcjellë përmes tryezave të konsultimit të zhvilluara fizikisht nëpër qarqe, apo online nëpërmjet platformave të ndryshme.

Nga sa raportohet nga anëtarët e grupeve të punës dhe strukturat teknike të hartimit të këtyre akteve, raporti i komenteve të marra gjatë kësaj faze, është në total 93 komente, ku ndarja sipas akteve paraqitet si më poshtë:

- Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.75/2014, “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”; **(8 komente)**
- Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023–2025 dhe të planeve të veprimit 2023–2025; **(31 komente)**
- Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.74/2014, “Për armët”, të ndryshuar; **(1 koment)**
- Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.113/2020, “Për shtetësinë”; **(1 koment)**
- Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030, të planit të saj të veprimit 2023-2025 e të pasaportës së indikatorëve; **(52 komente)**.

### **2.5.2. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?**

Komentet e mbledhura gjatë fazës së konsultimit publik, për aktet e sipërcituara e të konsultuara gjerësisht me grupet e interesit, kryesisht janë pranuar nga grupi i punës së hartimit të projektaktit apo nga struktura teknike. Në total, janë pranuar 87 komente, pranuar pjesërisht 5 komente dhe është refuzuar 1 koment.

Më konkretisht pasqyrojmë si vijon:



- Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.75/2014, “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”; **6 komente të pranuar plotësisht dhe 2 komente të pranuar pjesërisht.**
- Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023–2025 dhe të planeve të veprimit 2023–2025; **31 komente të pranuar plotësisht.**
- Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.74/2014, “Për armët”, të ndryshuar; **1 koment i pranuar plotësisht.**
- Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.113/2020, “Për shtetësinë”; **1 koment i refuzuar.**
- Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030, të planit të saj të veprimit 2023-2025 e të pasaportës së indikatorëve; **49 komente të pranuar plotësisht dhe 3 komente të pranuar pjesërisht.**

### **2.1.1. Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?**

Tendenca e pranimit të komenteve dhe sugjerimeve të dhëna nëpërmjet RENJK apo takimeve publike, mbetet e kënaqshme, duke theksuar një përmirësim gjatë këtij viti krahasuar me një vit më parë. Për sa i përket vitit 2023, numri i komenteve të marra gjatë fazës së konsultimit publik është më i kënaqshëm.

### **2.1.2. Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?**

Asnjë raport VNR nuk është ndryshuar apo përditësuar në bazë të informacionit të marrë gjatë konsultimit publik.

## **2.2. Raportet mbi rezultatet e konsultimit**

### **2.2.1. Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?**

Ministria e Brendshme ka publikuar në RENJK 6 raporte konsultimi për të 6 aktet e konsultuara dhe të planifikuara në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektateve për vitin 2023.

### **2.2.2. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?**

Nuk ka raporte të pa publikuara për aktet e konsultuara. Çdo akt i konsultuar nëpërmjet RENJK apo takimeve publike, është shoqëruar me raportin e rezultateve të këtij procesi, pavarësisht nëse janë marrë komente apo jo.

### **2.3. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik**

Referuar formatit të kërkuar nga njësia përkatëse në Kryeministri, e cila është hartuar nga MB argumentojmë si vijon:

**Indeksi Performancës** për cilësinë e konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme është **8**. Ky rezultat vjen si pasojë e kësaj llogaritjeje:

Shuma e pikëzimit për procesin e KP, pjesëtuar për numrin e akteve të konsultuara që është 8, indeksi rezulton të jetë **8 pikë** për cilësinë e konsultimit publik për vitin 2023, për Ministrinë e Brendshme.

Kurse në përqindje **indeksi sasior është 100%**, pasi të gjitha aktet e miratuara janë konsultuar dhe për to ka dëshmi të mjaftueshme mbi përfshirjen e palëve të interesit ku janë mbledhur prova të mjaftueshme mbi reagimet e tyre, një pjesë e mirë e të cilave janë reflektuar dhe në akt.

**3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen** *(Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)*

Sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik lidhen më së shumti me gjithë përfshirjen e publikut në këtë proces. Ende nuk reflektohet një kulturë e angazhimit në proceset e hartimit të politikave. Me gjithë përpjekjet dhe mundësitë e ofruara nga Ministria e Brendshme, ende nuk ka përfshirje aktive të publikut të RENJK në procesin e dhënies së rekomandimeve apo qëndrimeve për përmbajtjen e projektakteve që hartohen. Për periudhën e ardhshme, me qëllim përmirësimin e procesit, organizimi i konsultimeve është planifikuar të orientohet edhe më shumë përmes informimit më aktiv të publikut për përfshirjen në procesin e konsultimit publik. Kjo do të mundësonte një njohje dhe përdorim edhe më të mirë e të shtuar të metodave gjatë procesit të konsultimit publik dhe rritjen e pjesëmarrjes së publikut në konsultimin e projektakteve.